

Msc. Elsa SAKA

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

BASHKËPUNIMET E DPA-SË DHE ROLI I MEDIAS PËR INFORMIMIN E PUBLIKUT

***Përmbledhje:** Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në vitet e fundit ka ndjekur strategjinë e dyerve të hapura jo vetëm për studiuesit dhe të interesuarit, por edhe për publikun e gjerë. Në këtë mënyrë është arritur efekti në publik, se arkivat nuk janë dhe nuk duhet të shihen më si diçka e largët, e pamundur për t'u arritur lehtë. Kjo qasje ka ardhur pas bashkëpunimeve të shumta të DPA-së me institucione të ndryshme shtetërore dhe private në të gjithë vendin, por edhe përtej kufijve.*

Çdo lloj bashkëpunimi është frytdhënës në çastin kur krijohen lidhje ndërinstucionale, si dhe kur stafet janë specialistë të fushave përkatëse duke nxjerrë në pah, në forma të ndryshme, etapat historike apo të dhëna me interes historik e, ndoshta, të papublikuara më parë për vizitorët në masë të gjerë.

Megjithatë, të gjitha arritjet dhe puna e palodhshme realizuar nga stafi i DPA-së për digjitalizimin e arkivit që i mundëson çdokujt të ketë qasje te dokumentet të cilat i interesojnë nga komoditeti i ambientit të tyre vetëm duke klikuar në faqen e DPA-së, si dhe të gjitha bashkëpunimet institucionale nuk do të kishin pasur këtë ndikim siç kanë sot në publik pa një aleat tjetër siç është media. Nëpërmjet saj janë përcjellë vlerat e kësaj pune të madhe të arritur në pak kohë. Media të shumta kanë shprehur interesim të veçantë për përcjellje të ekspozitave të realizuara dhe të hapura nga DPA-ja.

Në këtë kumtesë do t'i paraqes disa prej bashkëpunimeve të realizuara me institucionet shtetërore apo private dhe çfarë vlere kanë pasur ato për publikun. Gjithashtu, do të paraqes cila është rruga që duhet ndjekur për ta pasur median aleate për përcjelljen e informacionit dhe përfitimet reciproke të kësaj aleance.

Fjalë kyçe: Media, arkiva, ekspozita, bashkëpunim, institucion

Vite më parë institucioni i Arkivit Qendror i Shtetit shihej pothuajse me “frikë” nga njerëzit e thjeshtë deri te studentët dhe studiuesit e rinj. Mjafton të vështrojmë pas dhe shumëkush prej nesh e mban mend murin rrethues të këtij institucioni i cili mbart brenda vetes kujtesën kolektive të popullit tonë. Ai mur ishte ndërtuar për t'i mbajtur njerëzit sa më larg arkivave, për të krijuar tek ata psikologjinë e frikës. Jo vetëm për qytetarët, por edhe për studiuesit apo edhe për gazetarët ishte shumë e vështirë, për të mos thënë e

pamundur, që të arrinin ta kalonin atë “mur”. Pasuria arkivore dokumentare që ruhej brenda mureve të këtij institucioni ishte e destinuar të shfrytëzohej vetëm nga një grup shumë i vogël njerëzish.

Situatë tashmë i përket së shkuarës. Prej disa vitesh Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka ndryshuar jo vetëm pamjen e jashtme, por ka transformuar rrënjësisht edhe metodologjinë e punës. Sot cilido qytetar mund të vijë dhe të punojë lirisht dhe i qetë në mjediset e DPA-së. Salla e studimit e DPA-së qëndron e hapur për publikun jo vetëm gjatë ditëve të javës, por ofron shërbimin e saj me kapacitet të plotë edhe në fundjavë, ditën e shtunë, duke u dhënë kështu mundësi atyre studiuesve të cilët gjatë ditëve të javës janë të angazhuar me punë zyrtare. Sot qytetarët marrin shërbimin e kërkuar pa pasur drojë se mund t’i refuzohet kërkesa e tyre dhe DPA tashmë është shndërruar në një partner besnik me qytetarin, studiuesin, hulumtuesin, apo dhe me median vendëse dhe atë përtej kufijve.

Futja në shërbim e teknologjive të reja ka mundësuar që dokumentacioni i kërkuar të ofrohet jo vetëm në mjediset e institucionit, por kudo që personi kërkuar ndodhet, qoftë brenda apo jashtë Shqipërisë, duke sjell rritjen e qasjes dhe të shfrytëzimit të dokumentacionit. Arkivi mundëson dërgimin e dokumentacionit arkivor në format të digjitalizuar për të gjithë personat e interesuar dhe të gjitha kërkesat e qytetarëve plotësohen tërësisht brenda afateve ligjore që nevojiten për të kthyer përgjigje.

Gjatë këtyre viteve të fundit ka pasur një përpjekje të jashtëzakonshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për të krijuar një pamje të re të saj, që t’i mundësonte të ishte më pranë kërkesave të njerëzve.

Gjatë kësaj kohe DPA, me nismën e drejtpërdrejtë të drejtorit të përgjithshëm, dr. Ardit Bido, ka zhvilluar një veprimtari të shumanshme për t’i hapur arkivat ndaj qytetarëve. Pjesë e kësaj strategjie ka qenë, ndër të tjera, edhe organizimi i ekspozitave të shumta në numër dhe të përgatitura me shumë përkushtim dhe profesionalizëm nga stafi i DPA-së. Gjithashtu, në punën tonë kemi bërë përpjekje ta shohim median si një aleate për t’i promovuar sa më shumë vlerat historiko-kombëtare të cilat ruhen në fondet e institucionit të Arkivit Qendror Shtetëror.

Gjatë këtyre viteve institucioni i DPA-së ka shtrirë në të gjitha nivelet e mundshme sferat e bashkëpunimit, që nga institucionet shtetërore apo private shqiptare deri te marrëveshjet me institucione të huaja si, për shembull, me arkivat e Turqisë,¹ të Maqedonisë, të Kosovës dhe rinovimin e marrëveshjes me arkivin e Kroacisë.² Këto bashkëpunime kanë qenë tepër të frytshme qoftë për pasurimin e fondeve arkivore në bazë të marrëveshjeve si, për shembull, nga bashkëpunimi me Arkivin e Turqisë është përfituar një

¹ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tokës dhe Regjistrave të Kadastrës.

² Informacion mbi vizitën e delegacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave në Zagreb.

sasi shumë e madhe dokumentacioni arkivor që ka lidhje të drejtpërdrejtë me Shqipërinë dhe me shqiptarët. Nga ana tjetër, nga bashkëpunimi me institucionet shqiptare si, për shembull, me Akademinë e Studimeve Albanologjike është bërë i mundur botimi i mjaft dokumenteve që ndodhen në fondet e AQSh-së.

Kështu, hap pas hapi dhe punë pas pune, u bë i mundur digjitalizimi i fondit të dokumenteve në gjuhën osmane në bashkëpunim me Arkivin Shtetëror të Turqisë. Në bazë të kësaj marrëveshjeje u arrit digjitalizimi i plotë i fondit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. U skanuan 469 624 fletëdokumente në një periudhë kohe prej 18-muajsh. Po ashtu, është bërë një punë shumë e madhe edhe për digjitalizimin e fondeve të klerit. Kjo është arritur në bazë të marrëveshjeve të lidhura me përfaqësues të klerit dhe DPA-së. Gjithashtu, po veprohet për fondet e klerit katolik dhe ortodoks, për të cilat aktualisht po vijon puna për digjitalizimin e tyre në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet drejtuesve përkatës të tyre dhe drejtorit të përgjithshëm të DPA-së, dr. Ardit Bido.

Nga larmia e madhe e bashkëpunimeve të realizuara ndërmjet DPA-së dhe institucioneve të tjera po shkëpusim disa prej tyre për t'i radhitur në këtë punim, për arsye se është e pamundur që të riprodhohen të gjitha për shkak të vëllimit të tyre tepër të madh.

Më 28 tetor 2019 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Komunitetin Katolik në Shqipëri, me synim të digjitalizimit të dokumenteve arkivore të Komunitetit Katolik në Shqipëri. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, dr. Ardit Bido dhe ipeshkvi Gjergj Meta. Nga të dyja palët kjo marrëveshje u vlerësua shumë e rëndësishme, pasi ndër të tjera, në njëfarë mënyre vendoste në vend një padrejtësi që i ishte kryer këtij komuniteti në një periudhë të caktuar të historisë të shtetit shqiptar.

Ndër bashkëpunimet e suksesshme të DPA-së mund ta përmendim dhe bashkëpunimin me Kalanë e Tiranës për realizimin e një sërë ekspozitave. Kështu, me rastin e 106-vjetorit të botimit të parë të revistës “Hylli i Dritës”, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ekspozoi në mjediset e Kalasë së Tiranës një pjesë të numrave të revistës të themeluar nga Atë Gjergj Fishta në tetor të vitit 1913. Ekspozita u realizua në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare dhe Kalanë e Tiranës. Vizitorët patën mundësinë dhe rastin ta vështronin nga afër koleksionin e kësaj reviste që ruhet në fondet e Bibliotekës së DPA-së dhe në Bibliotekën Kombëtare.³

Një ndër format e tjera të bashkëpunimit organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka qenë edhe mbajtja e seminareve për trajnimin e punonjësve të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore për punën në sekretari-arkiv. Kështu, më 1 nëntor 2019 përfundoi me sukses seminari teorik-praktik për krijimin, evidentimin, klasifikimin, shërbimin dhe ruajtjen

³ Raport vjetor i Drejtorisë së Evidencës Qendrore dhe Komunikimit, 2019.

e dokumenteve, të organizuar për punonjësit e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore për punën në sekretari dhe arkiv. Ky seminar kishte për qëllim ngritjen profesionale dhe shkencore të punonjësve të sekretari-arkivave të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore.

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave ka bashkëpunuar edhe me institucionet e arsimit të lartë. Kështu, më 6 nëntor 2019 përfundoi me sukses fazën e dytë të bashkëpunimit me Albanian University.⁴ Studentët e Fakultetit të Shkencave Shoqërore të këtij universiteti ishin pjesëmarrës në projektin e “Digjitalizimit të inventarëve të fondeve të arkivave vendore të viteve 1945-1968 të ish-komiteteve ekzekutive” gjatë periudhës prill-maj 2019. Po më 18 nëntor 2019 studentët të Universitetit të Tiranës - dega Arkivistikë, në kuadër të lëndës mësimore “Aftësimi për informacion”, ishin në mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Studentët u njohën me mënyrën se si bëhet sistemimi dhe përpunimi i një dokumenti, si një nga proceset më të rëndësishme të punës në DPA. Gjithashtu, u informuan nga afër për vendruajtjen e dokumenteve origjinale si dhe për një nga format e ruajtjes, në mikrofilm (bobina dhe xhaketa). Më 20 janar 2020 studentët e degës së spanjishtes në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në një tur në Arkivin Qendror Shtetëror panë një mori punësh që kryhen në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, veçanërisht u njoftuan për procesin e gjetjes dhe porosisë së një dokumenti në katalogun online.

Më 27 janar 2020 do të nënshkruhej marrëveshja në mes të DPA-së dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, me synimin që studentët të ndihmojnë për përpunimin e dokumenteve në gjuhë të rralla, të cilat nuk ka arkivist që t'i dijë, dokumente të cilat kanë mbetur stok prej kohësh në vendruajtjen e DPA-së për shkak të pamundësisë objektive që të njihen ato gjuhë.

Më 7 nëntor 2019 Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave së bashku me Muzeun Historik Kombëtar sollën për publikun ekspozitën “Dekorata dhe medalje”.⁵ Në këtë ekspozitë u paraqitën dekorata dhe medalje me të cilat janë nderuar personalitete shqiptare e të huaja për meritat e tyre të pashembullta për përfaqësimin dhe ngritjen e kombit dhe Shqipërisë.

Në fushën e botimeve Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave ka realizuar projekte bashkëpunimi me institucione shtetërore shqiptare dhe ato të Republikës së Kosovës. Kështu, më 16 nëntor 2019 DPA prezantoi dy botime të reja. Botimi i parë është botim i përvitshëm i revistës “Arkivat shqiptare” që vjen në bashkëpunim me Agjencinë e Arkivave të Kosovës⁶, ndërsa botimi i dytë është përmbledhje dokumentesh “Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit”, vëllimi II, në bashkëpunim

⁴ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Albanian University, 2017.

⁵ Raport vjetor i Drejtorisë së Evidencës Qendrore dhe Komunikimit, 2019.

⁶ Aneksi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, 2018.

me Akademinë e Studimeve Albanologjike dhe me Fondacionin “Konrad Adenauer”.

Me rastin e 120-vjetorit të lindjes të poetit Llazar Sotir Gusho (Lasgush Poradeci), më 22 dhjetor 2019 në qytetin e Pogradecit, bashkia e këtij qyteti organizoi një ekspozitë përkujtimore në të cilën Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dha kontributin e saj duke ofruar dhe vënë në dispozicion dokumentet e rralla të dhuruara nga e bija e poetit të cilat ruhen në AQSh.⁷

Më 23 dhjetor 2019 do të realizoheshin edhe dy marrëveshjet e fundit në lidhje me digjitalizimin e fondeve të komuniteteve fetare në Shqipëri.

Ndër të tjera, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me dy komunitete fetare, Kishën Ortodokse Autoqefale⁸ të Shqipërisë si dhe Rabinatin e Shqipërisë për kryerjen e procesit të digjitalizimit të fondeve arkivore dhe të çdo materiali tjetër që është krijuar nga këto dy komunitete dhe që ruhen në AQSh. Në marrëveshjen e parë të pranishëm ishin drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, dr. Ardit Bido dhe përfaqësuesi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Episkop Asti. Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin e dy institucioneve për digjitalizimin e dokumenteve arkivore të komunitetit ortodoks dhe institucioneve të tij që ndodhen në AQSh. Ndërkaq, Rabinati Shqiptar u përfaqësua nga kryerabini i Shqipërisë, Yoel Kaplan. Në marrëveshje parashihet digjitalizimi i të gjithë fondit arkivor të personave dhe organizmave të hebrenjve në Arkivin Qendror Shtetëror, me kostot e Rabinatit, si dhe do të bashkëveprojnë për botimin e katalogëve të referencave arkivore mbi hebrenjtë në Shqipëri.⁹

Më 21 janar 2020 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, së bashku me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në një ekspozitë me fotografi e dokumente të rralla shënuan 100-vjetorin e formimit të Parlamentit të Shqipërisë si organi më i lartë ligjvënës. Ekspozita e titulluar “100-vjetori i parlamentarizmit në Shqipëri” përbëhej nga 32 stenda. Ajo u shfaq në ambientet e Pallatit të Kongreseve. Nëpërmjet fotografive dhe dokumenteve arkivore shihet rrugëtimi 100-vjeçar i parlamentit. Kjo ekspozitë fillonte me Kongresin e Lushnjës, i cili mori vendime për rimëkëmbjen e shtetit shqiptar, për sigurimin e pavarësisë dhe mbrojtjen e tërësisë territoriale të tij, ndërsa përfundonte me figura të shquara botërore që kanë vizituar Kuvendin.¹⁰

Këto janë vetëm disa prej marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve të realizuara ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe

⁷ Raport vjetor i Drejtorisë së Evidencës Qendrore dhe Komunikimit, 2019.

⁸ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, 2019.

⁹ Marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Rabinatit Shqiptar, 2019.

¹⁰ Raport vjetor i Drejtorisë së Evidencës Qendrore dhe Komunikimit, 2019.

institucioneve të tjera shtetërore dhe private, vendëse dhe të huaja. Objektivi dhe qëllimi kryesor i tyre ka qenë hapja sa më shumë e arkivave, bërja e tyre të prekshme nga të gjithë qytetarët, ekspozimi i dokumentacionit historik arkivor jo vetëm në mjediset e Arkivit, por edhe në mjedise të tjera publike, si në qytete të tjera dhe më tej. Natyrisht që ndihmesë të madhe për përcimin e mesazhit drejt qytetarëve kanë dhënë mediat, të cilat kanë pasqyruar hap pas hapi punën e bërë nga institucioni ynë për promovimin e historisë së popullit tonë që ruhet në fondet e AQSh-së.

Gjatë këtyre bashkëpunimeve me institucione të ndryshme shtetërore dhe private, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë të vendit tonë, kemi pasur si bashkëshoqërues të vlefshëm edhe mediat e shkruara dhe atë televizive. Puna e realizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në bashkëpunim me institucione të ndryshme, është paraqitur për publikun e gjerë nga shumë media. Pra, përkrah bashkëpunimeve të frytshme ndër vite, kemi pasur edhe një aleat të vyer i cili bënte të mundur që puna jonë të transmetohet te masa e gjerë dhe arkiva të mos dukej mur i lartë i pakapërcyeshëm, por të shërbente si urë e cila i mundësonte secilit qytetar ta gjente historinë e vet.

Synimin të cilën ia kemi vënë vetes si institucion për t'i shërbyer me devotshmëri çdo personi i cili vjen në arkiv, duke hapur dyert e arkivit për çdokënd dhe duke shndërruar arkivin në një institucion me dinjitet, si vend ku ruhen me kujdes historia dhe trashëgimia e vendit tonë, e kemi arritur me sukses. Kjo arritje është vërtetuar me punën e prekshme nga kushdo dhe nëpërmjet bashkëpunësorëve tanë të cilët i janë bashkuar nismës tonë. Realisht, secili prej tyre ka vendosur një gur në kështjellën madhështore të arkivit shqiptar.